



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA  
GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

---

Numri i lëndës: 2023:156917  
Datë: 18.06.2024  
Numri i dokumentit: 05828760

C.nr.671/2023

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Betim Behluli, me bashkëpunëtorin profesional Armond Qmega, në çështjen juridike të paditëses E.S, nga Prizreni, të cilin e përfaqëson Av. D.M, nga Prizreni, kundër të paditurës S në Prishtinë, lidhur me kompenzimin e dëmit, vlera e kontestit 1,500.00 €, me datë 18.06.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

Padia e paditëses E.S, nga Prizreni, e ushtruar pranë kësaj gjykate, kundër të paditurës S në Prishtinë, lidhur me kompenzimin e dëmit, KONSTATOHET E TËRHEQUR.

Lënda si e kryer ti deponohet arkivit të gjykatës.

**A r s y e t i m**

Paditësja E.S, nga Prizreni, ka ushtruar padinë kundër të paditurës S në Prishtinë, lidhur me kompenzimin e dëmit.

Përfaqësuesi i autorizuar i paditëses me parashtrësë të veçantë prej datës 18.01.2024 e ka tërhequr padinë.

Andaj kjo gjykatë e duke u mbështetur në dispozitat e nenit 261 paragrafi 1 dhe 4 të Ligjit për Procedurën Kontestimore të Kosovës, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi, duke konsideruar se padia e paditëses është tërhequr.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA RAHOVEC  
C.nr.671/2023, më 18.06.2024

B. Profesional  
Armond Qmega

Gjyqtari  
Betim Behluli

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa e veçantë.